

# UNIVERSITETI I GJAKOVËS “FEHMI AGANI”

## FAKULTETI I FILOLOGJISË

Dega: Letërsi shqipe



## RRETH ROMANIT *RRATHË* TË MARTIN CAMAJT

Punim diplome

MENTORI:

Prof. Ass. Dr. LABINOT BERISHA

KANDIDATJA:

BESARTA DAKAJ

Gjakovë 2018

## PASQYRA E LËNDËS

ABSTRAKT .....	3
HYRJE .....	4
I. MARTIN CAMAJ "NJË TJETËR SHKODRAN" .....	6
1.1. Camaj poet .....	6
1.2. Camaj prozator .....	10
1.3. Camaj dramaturg .....	12
II. RRETH ROMANIT <i>RRATHË</i> TË MARTIN CAMAJT .....	13
2.1. Romani <i>Rrathë</i> dhe simbolika e tij .....	13
2.2. <i>Rrathë Uji</i> .....	15
2.3. <i>Rrathë Zjarmi</i> .....	17
2.4. <i>Rrathë Gjaku</i> .....	20
III. PERSONAZHET DHE GJUHA .....	22
3.1. Diskursi i personazheve .....	22
3.2. Pasuri gjuhësore .....	26
PËRFUNDIM .....	30
LITERATURA .....	31

## Abstrakt

Edhe pse letërsia shqipe e periudhës kur jetoi dhe veproi Martin Camaj ishte një letërsi tërësisht ideologjike, ai, në sajë të talentit dhe shpirtit të lirë artistik gjeti hapësirë dhe teknika letrare, që të mos binte në pozitat e një shkrimtari konformist. Kjo i solli edhe madhështinë e veprës së tij. Profili i tij shumëdimensional arriti pedestalin artistik me botimin e romanit *Rrathë* (Munih 1981). Me romanin *Rrathë*, Camaj nuk ka respektuar asnjë prej normave krijuese të parimit socrealist (nuk kemi kufi të prerë mes “heroit pozitiv” dhe atij “negativ”). Romani ka në qendër të vëmendjes një realitet të tërthortë në Shqipëri. Një sistem i ri i vendosur në fshatin imagjinar të Rripës dhe krahinave përreth bëhet shkas për tragjiken në jetën e njerëzve. Përveç kësaj, romani ka në sfond edhe temën që ripërsëritet disa herë në fatin e shumë personazheve. Njeriu përballë vetmisë dhe humbja e termit të kohës është në qendër të këtij romani. Zhvendosja e vëmendjes nga bota e jashtme e ngjarjet, në botën e brendshme të personazheve, në thellësinë psikologjike të tyre, bëjnë që ky roman të ketë premise të theksuara psikologjike dhe të jetë një ndër romanet më të mira të letërsisë bashkëkohore shqipe.

**Fjalët kyçe: Poet, prozator, dramaturg, rrathë, uji, gjaku, zjarri.**

## HYRJE

Deri sa në Shqipëri zhvillohej një letërsi tërësisht e angazhuar ideologjike, kishte edhe prej atyre guximtarëve që jetonin brenda e jashtë kufirit shtetëror që dolën nga këto parime ideologjike. Sigurisht shpirti i tyre artistik nuk mundi assesi të ngulfatet e të shkruante vetëm sipas një sistemi të caktuar. Shpirti artistik kërkon lirinë e të shprehurit, me të gjitha përmasat krijuese. Një nga këta artist që nuk mundi assesi të pajtohet me këtë letërsi ideologjike ishte edhe Martin Camaj. Refuzimi ndaj dogmës së realizmit socialist, nëpërmjet jetës, veprës e shprehjes së tij, bëri që vepra letrare e Camajt por edhe emri i tij të qëndrojnë për një kohë relativisht shumë të gjatë të pazbuluara dhe në errësirë për lexuesin shqiptar. Kjo pasi ishte i ndaluar nga sistemi komunist, meqë ishte njëri ndër kundërshtarët më të zëshëm të këtij sistemi. Vetëm pas rënies së sistemit komunist, pas vitit 1990, Camaj zuri vendin e nderit në letërsinë shqipe.

Letërsia e tij, shkruar e botuar në mërgim, është e veçantë si në përdorimin e tematikave ashtu edhe në përdorimin e gjuhës. Në përgjithësi në të gjithë krijimtarinë letrare të Martin Camajt hasim në stilin e një krijuesi origjinal të gërshtuar me botën e pasur folklorike dhe mitologjike. Ai është shkrimtari të cilit duhet t'i kthehesh dhe rikthehesh kohë pas kohe sepse asnjëherë nuk mund ta zbulosh të tërin, gjithmonë të shpëton një kuptim i fshehtë i krijimtarisë letrare të tij. Prandaj letërsia e tij është një botë unike ku lexuesi mund të eksplorojë deri në pafundësi. Si në prozë ashtu edhe në poezi Camaj i largohet mitit të njeriut ideal, të cilin e ndërtoi letërsia e realizmit socialist. Në vend të këtij heroi, letërsia e Camajt merr si personazhe karaktere të ndryshme njerëzish, të cilët nuk kanë asnjë funksion moralizues. Një dimension tjetër artistik i Camajt ka të bëjë me pasionin e tij ndaj studimeve gjuhësore. Ndhimesa e çmuar e këtij poeti, prozatori, dramaturgu, gramatikani të shquar e pasuroi kulturën shqiptare. Ai shkroi poezi, prozë dhe drama. Në fushën e prozës lëvroi format letrare si tregimin (në dorëshkrim), prozën poetike, novelën dhe romanin.

Romani *Rrathë* është vepra në të cilën ai derdhi gjithë talentin e tij krijues. Objekti i ndërtimit të romanit është roli i individit në mesin shoqëror. Ngjarjet në roman zhvillohen në një periudhë shumë të shkurtër kohore, në disa ditë, as edhe një javë të vetme. Pas ngjarjeve kryesore, kemi një shkëputje subjektore për njëzet vite. Tërë romani ka disa

simbolika po dy që mbizotërojnë veprën, lidhen me traditën e pasur epike shqiptare. Janë simbolika e Rapsodit dhe lahutës që e pasurojnë artistikisht këtë vepër letrare. Pjesë përbërëse e veprës është edhe bota e pasur mitologjike shqiptare. Besimi në Orët e malit, në roman, më shumë na del si konflikti mes dy gjeneratash, mes të rinjve dhe të moshuarve.

Në leximin e veprës së Camajt në tërësi, por edhe të këtij romani në veçanti, ndjehet fort arti i fjalës, i gjuhës artistike të shkrimtarit. I shkruar në një gegërishte shumë të avancuar letrare, ashtu siç shkruante vetëm Camaj, duke thyer kështu “mitin” e vjetër se gegërishtja është vetëm gjuhë më të cilën shkruhen poezitë, romani është një nga veprat më të mira të letërsisë bashkëkohore shqipe. Një arsye, e cila e shton edhe më shumë kërshërinë për studimin e romanit *Rrathë* të Martin Camajt lidhet me faktin se kritika e ka vlerësuar si romanin e parë psikologjikë në letrat shqipe.

## **Baza teorike e punimit**

Tema e diplomës me titull *Rreth romanit Rrathë të Martin Camajt* është një provë për të pasqyruar një tablo të përgjithshme të teknikave ligjërimore, narrative si dhe aspekteve gjuhësore të romanit që kemi marrë në shqyrtim. Paraqitja e strukturuar e profilit shumëdimensional të Camajt si poet, prozator dhe dramaturg bëhet me qëllim që të vihen në dukje përmasat e këtij shkrimtari. Në anën tjetër, interpretimet e simbolikës që ngërthen romani dhe përshkrimet e bazuara në teoritë narrative do të kenë qëllim kryesor të dallojnë të veçantën dhe individualitetin e personazheve që jetësojnë rrëfimin artistik. Vëmendja jonë ka qenë më shumë te bota psikologjike e personazheve që gjallojnë në roman dhe marrëdhënieve që kanë ata me njëri-tjetrin. Marrë si tërësi, objekti i këtij punimi të diplomës është një hulumtim i përgjithshëm i veçorive artistike, stilistike dhe gjuhësore të kësaj vepre letrare. Në përgjithësi punimi do të orientohet te elementet simbolike, folklorike dhe mitologjike që ndërthuren me personazhet dhe domethënien e këtyre elementeve.

## Metodologjia e punës

Gjithë analiza është bërë duke përdorur koncepte të kritikës bashkëkohore. Gjatë realizimit të këtij punimi diplome, për hir të vetë procesit kërkimor-shkencor, i jemi drejtuar disa metodave të ndryshme studimore. Fillimisht kemi shfrytëzuar metodën historike për t'u njohur me disa elemente të biografisë së autorit. Pastaj i jemi drejtuar metodës komperative (krahasuese), përfaqesjes së brendshme, për të evidentuar të përbashkëtat dhe dallimet mes personazheve të romanit *Rrathë*. Metoda interpretative, analizat konkrete janë një bosht shumë i rëndësishëm i këtij punimi diplome. Në interpretimin e romanit *Rrathë* do të shqyrtohen dhe theksohen kontaktet e këtij teksti me sferat e tjera të kulturës. Nga këto sfera do veçohen dhe vihen në dukje; elementet mitologjike, legjendat, simbolet dhe zakonet e ndryshme. Teksti do të trajtohet si një tekst mozaik, i cili bashkëvepron shumë edhe me elemente të fushave tjera që lidhen në një mënyrë ose tjetrën me artin e fjalës-letërsinë.

## Synimi i temës

Pjesa e parë e këtij punimi diplome synon të japë një pasqyrë të plotë të veçorive themelore të krijimtarisë letrare të Martin Camajt si poet, prozator dhe dramaturg. Pjesa e dytë e këtij punimi synon të paraqes një tablo të plotë të romanit që kemi zgjedhur për analizë. I ndarë në tre kapituj, me tri simbolika të ndryshme, romani *Rrathë* qëndron në krye të krijimtarisë në prozë të Martin Camajt. Në këtë pjesë jemi fokusuar në përshkrimin e teknikave narrative për paraqitjen e simbolikës së rathëve. Pjesa e tretë e këtij punimi synon të japë një panoramë gjithëpërfshirëse të personazheve që përfshihen në roman dhe veçorive gjuhësore të veprës në fjalë. Punimi synon të nxjerrë në pah karakteristikat kryesore letrare të secilit prej personazheve. Në këtë kontekst, synojmë që ky punim të jetë një pasqyrë e përgjithshme e romanit *Rrathë*, e cila është një vepër me vlera të mirëfillta letrare, etnografike, gjuhësore dhe psikologjike.

# I. MARTIN CAMAJ "NJË TJETËR SHKODRAN"

## 1.1. Camaj poet

Krijimtaria letrare e Martin Camajt<sup>1</sup> u zhvillua në një periudhë rreth dyzetepesëvjeçare. Ajo kalon nëpër disa etapa zhvillimi. Bazuar në shkrimet, studimet, monografitë kushtuar Camajt, mund të pohojmë se ai jetën letrare e nisi pikërisht me poezi. Në fushën e poezisë ai u dëshmuoi poet i pasqor i cili me vargjet e tij tregoi talentin e një krijuesi të pazëvendësueshëm. Figura e tij është shembulli më i mirë në të cilën bashkohet figura e poetit dhe studiuesit. Bën pjesë ndër ata poet, të cilët muza poetike nuk i braktisi kurrë, pasi shkroi poezi gjatë fundit të jetës së tij.

Në revistën letrare *Jeta e re*, më 1951 botoi poezitë *Mësuesi i ri* (nr. 5) dhe *Mullini i ujit* (nr. 6), me të cilat ai e përuroi jetën e tij letrare. Vetëm dy vite më vonë letërsia shqipe do të ketë veprën e parë poetike të tij, nga ndërmarrja botuese *Mustafa Bakija* e Prishtinës, veprën *Një fyell ndër male* (1953). Ky libër i përbërë nga 40 poezi, do jetë një “revolucion letrar” në jetën kulturore në Kosovë, pasi me të fillojnë botimet e mirëfillta letrare në vendin tonë. Një vit më vonë, më 1954, do të botoi edhe vëllimin e dytë me poezi të titulluar *Kanga e vërrinit*, përsëri në Prishtinë. Gjatë qëndrimit në Itali boton vëllimin me poezi *Legjenda në Romë*, më 1964.

Në Gjermani boton librat e fundit poetikë: *Lirika mes dy moteve*, Munihi 1967, *Njeriu më vete e me të tjerë*, Munihi 1978, *Poezi 1953-1967*, Munihi 1981. Në vitin 1990 botohet përmbledhja *Selected Poetry* (New York & London), me poezi të përzgjedhura në gjuhën shqipe dhe angleze, ku përfshihen edhe dy cikle shumë të rëndësishme, të cilat poeti i shkroi në vitet e fundit të jetës së tij: *Nema* dhe *Buelli*. Gjithashtu, si përkthime të Leonor Foxi-it doli në qarkullim edhe përmbledhja *Palimpsest* (Munihi & New York), në vitin 1991.

---

<sup>1</sup> Martin Camaj u lind në Temal të Dukagjinit më 21 korrik 1925. Ai mori edukatë klasike në Kolegjin Ksaverian të Shkodrës, të drejtuar nga etërit jezuitë. Mbas pak kohësh, për shkak të vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri, Camaj do të arratiset nga vendi për në Jugosllavi, ku ia del të regjistrohet si student në Universitetin e Beogradit. Në këtë Universitet Camaj iu fut punës me zell për formim shkencor. Atje mësoi italianistikë, romanistikë, teori letërsie, gjuhë klasike dhe sllavistikë, një botë e re kjo për një intelektual si ai, të edukuar në Shkodër. Largohet nga Jugosllavia në verën e vitit 1956. Shkon në Romë, ku studion sërish dhe doktorohet. Në Romë ndjek rrethet letrare të këtij qyteti. Atje nën kujdesin e Koliqit bëhet kryeredaktor i revistës *Shejzat* (1957-1975) dhe studion së afërmi botën arbëreshe. Më 1961, e lë Italinë dhe shkon në Gjermani, ku specializohet përfundimisht në fushën e Gjuhësisë shqipe, por asnjëherë nuk hoqi dorë nga letërsia. Nga 1970 deri më 1990 ishte profesor i albanologjisë në Universitetin e Munihut dhe jetoi në fshatin malor Lenggries në Bavarinë e Epërme derisa vdiq më 12 mars 1992.

Krijimtaria poetike e Camajt ka fituar pjekuri artistike gjatë kalimit të viteve, për shkak edhe të përvojës së tij jetësore dhe kontaktit të tij me kultura të ndryshme. Bazuar në tipare specifike të poezive, ku përfshihen kursi stilistik, temat dhe frymëzimet, studiuesit në krijimtarinë letrare të tij dallojnë tri periudha poetike. Martin Camaj personifikon njeriun i cili bashkë me fazat e shtegtimit të jetës së tij nëpër hapësira të ndryshme gjeografike (Jugosllavi, Itali, Gjermani) ka ndryshuar edhe shprehjen e tij artistike dhe stilistike.

Periudha e parë e cila përfshin vitet 1953-1967, karakterizohet me prirjet të cilat janë të ngritura mbi shtratin e poezisë tradicionale të kohës. Meqenëse Camaj ka pasur për mësues poetin e madh shqiptar Ndre Mjedën, reflektohet shumë ndikimi i tij në përdorimin e vargut njëmbëdhjetërokësh, gjë që shpërfaq traditën e poezisë së kultivuar shqipe në veprat poetike të tij. Përveç vargut njëmbëdhjetërokësh Camaj përdor shumë edhe vargun tetërokësh i cili është një lloj sinonim i krijimtarisë gojore. Duke pasur parasysh dy vëllimet e para të botuara me poezi *Një fyell ndër male* dhe *Kanga e vërrinit*, ai shquhet për këtë frymë tradicionale. Këto dy vepra poetike të cilat i botoi në Prishtinë, më së miri shpërfaqin identitetin e këtij poeti dhe karakteristikat stilistike të periudhës së parë krijuese të tij, pasi përshkohen nga e njëjta frymë. Ligjërimi poetik në këto dy vepra fillestare të tij është ngritur mbi frymën e poezisë tradicionale dhe janë të frymëzuara nga malet e vendlindjes, dashuria për të cilat nuk iu shua kurrë. Në të dy vëllimet përcaktohen karakteristikat kryesore të artit klasik në aspektin formal dhe tematik, prandaj ka studiues që këtë periudhë e quajnë periudha klasike. Vetë titujt e veprave, shënjojnë një ambient të caktuar, ambientin e malit e vrrinit. Mjedisi malor dhe ëndrrat e ngulitura aty përgjithmonë përbëjnë thelbin e kësaj periudhe filluese të tij. Tërë krijimtaria letrare e Camajt ka një gërshetim të natyrshëm me vendlindjen e tij si mall dhe frymëzim. Pikërisht vendlindja në vargjet e tij mund të konsiderohet si një jetësim artistik. Në përgjithësi kemi një koncentrim të pak motiveve, por që janë shprehje të qenësisë së vendlindjes si motivi i malit dhe vrrinit. Edhe në krijimtarinë e mëvonshme letrare, ndikimi i vendlindjes, i Temalit të tij të dashur do të jetë i vazhdueshëm.

Me botime të tilla si *Njeriu me vete e me të tjerë*, *Legjenda* dhe *Lirika mes dy moteve* poeti i largohet tradicionales, por nuk i shmanget tërësisht asaj. Kjo është karakteristike për periudhën e dytë krijuese të tij e cila përfshin vitet 1967-1978. Bota fizike e cila në vëllimet



e para kishte vëmendjen maksimale, tash zvogëlohet ndjeshëm. Edhe pse pasurohet me elemente stilistike e gjuhësore, ai as në këtë periudhë nuk i largohet tërësisht tharmit të motiveve nga vendlindja e tij.

Periudha e tretë (1978-1992) e shfaq shkallën më të lartë poetike të Camajt. Në këtë periudhë përfshihen ciklet *Nema* dhe *Buelli* dhe vëllimi *Palimpsest*. Në këtë periudhë poezia e tij thellon edhe më shumë karakterin artistik e stilistik. Format gjuhësore e strukturore përsosen deri në pedestalin më të lartë. Poezitë e tij meditative shfaqen me anë të simboleve dhe metaforave të shumta. Temat filozofike, problemet ekzistenciale të njeriut si jeta dhe vdekja, trajtohen përmes një simbolike të gërshetuar mes tradicionales dhe mitologjikes.

Vlen të ceket se i vetmi element i pandryshueshëm i cili qëndron permanent gjatë këtyre tri fazave është shkrimi i poezive në variantin letrar të gegërishtes. Këtë sistem gjuhësor ai nuk e braktisi gjatë gjithë jetës së tij. Gjuha si një mjet substancial për krijimet poetike, në poezitë e Camajt përpunohet e fiton vlera të reja estetike.

*Një karakteristikë themelore e poezisë së M. Camajt është prania e një simbolike të thellë, rrezatuese e polisemike.*<sup>2</sup> Gjithashtu te poezitë e tij është i pranishëm edhe sistemi i antonimive. Te krijimtaria e tij letrare dallohen qartë disa çifte antonimike si: sisteme duale gjeografike (veri-jug, mal-vërri), sisteme duale të personazheve (djalë-vashë, burrë-grua), sisteme duale nga bota e shpendëve (korb-pëllumb) etj. Ky sistem lidhet edhe me faktin se gjithmonë figurat simbolike në poezitë e tij janë duale.

Duke parë tiparet artistike të vëllimeve poetike të Martin Camajt theksojmë se poezia shqipe është pasuruar shumë dhe është bërë mjaft e larmishme, në aspektin formal dhe përmbajtësor, me vargjet e këtij poeti. Ai pati një poetikë të veten shumë të veçantë, krejt të ndryshme nga poetët e tjerë, poetikë e cila nuk u lakua asnjëherë gjatë gjithë jetës së tij. *Së këndejmi, mund të themi me gjithë mend se kjo poezi e Camajt është shembull dhe dëshmi e njëmendët sesa njeriu mund të pasurohet e të fisnikërohet shpirtërisht nga vlera kulminante e artit letrar.*<sup>3</sup>

---

<sup>2</sup> Roland Zisi, *Letërsi bashkëkohore shqipe-Poezia*, Naimi, Tiranë, 2015, fq. 62.

<sup>3</sup> Anton Nikë Berisha, *Vepra letrare e Martin Camajt*, Botimet Princi, Tiranë, 2010, fq. 69.

Si përfundim, vlen të theksojmë se vetëm pas viteve 90-të, në kushtet krejt tjera e në një realitet të ri, poezia e tij paraqet një rrafsh të ri cilësor të shprehjes dhe përsosjes poetike.

## 1.2. Camaj prozator

Ndonëse Martin Camaj e nisi jetën letrare me poezi dhe kësaj gjinie i mbeti besnik gjithë jetës pasi muza poetike nuk e braktisi kurrë ai njihet më shumë si poet. Por, ai mbetet po aq i veçantë edhe në fushën e prozës, fushë kjo në të cilën ai punoi gjithë jetën e tij. *Ai e përftoi prozën për arsye se ajo i ofroi ndonjëherë mundësi më të mëdha për shpëlimin dhe për shqiptimin më të plotë të ndonjë objekti artistik; depërtimin më të thellë në disa aspekte të jetës dhe të dramave të individëve ose të kolektivitetit, në raportet që e cilësojnë mjedisin ose trevën ku vendoset ngjarja ose subjekti i veprës letrare.*<sup>4</sup> Ai lëshroi të gjitha llojet e prozës duke filluar nga tregimi (ndonëse i la dy tregime në dorëshkrim), novela, romani dhe formën e ndërlikuar letrare, prozën poetike. Edhe pse veprat e tij në fushën e prozës kanë disa gjëra të përbashkëta, prapëseprapë, secila prej tyre përfaqëson një risi dhe identitet ndryshe nga tjetra si në krijimtarinë e autorit, ashtu edhe në letërsinë shqipe.

Pas botimit të dy vëllimeve me poezi në Prishtinë, Camaj boton në Romë, më 1958 romanin *Djella*. Poetika e këtij romani është mjaft e ndërlikuar. Ndonëse romani është shkruar në prozë, aty gërshetohen edhe disa elemente thelbësore të poezisë. Romani *Djella* është sprova e parë në fushën e prozës për Martin Camajn. Objekti artistik i romanit është një lloj rrëfimi poetik i personazhit të Bardh Qerretit në fshatin e tij të lindjes. Aty përballen dy botë të kundërta, ajo e malësorit dhe bota e njeriut të arsimuar e intelektual. Dielli, nga pikëpamja gjuhësore është emër i gjinisë mashkullore. Camaj e emërton veprën *Djella* duke ia dhënë këtij emri një trajtë femërore.

Një nga format më të ndërlikuara letrare është proza poetike, e cila konsiderohet si formë e ndërmjetme mes poezisë dhe prozës. Ajo edhe pse ruan karakteristikat e të dyjave, funksionon si formë letrare e pavarur. Në këtë formë letrare është shkruar vepra *Dranja*. Këtë vepër të ndërlikuar letrare filloi ta shkruante rreth vitit 1975 dhe mbaroi më 1979. Kjo

---

<sup>4</sup> *Po aty*, fq. 72.

formë e të shkruarit është një hap i guximshëm i autorit, sprova e cila i doli një kryevepër e letërsisë shqipe. *Nga të gjitha veprat në prozë të Martin Camajt Dranja (1981) ka sistemin më të ndërliqshëm kuptimor, ka simbolikën më shtresore dhe cilësore më gjuhës më të pasur poetike.*<sup>5</sup> Këtë mendim të studiuesi A. N. Berisha e përlligj fakti se prozat poetike në këtë vëllim janë të gërshetuara me madrigalin. Madrigali është një gjini e lirikës erotike, që fillimisht është shkruar në vargje dhe ende vazhdon të shkruhet si i tillë. Por, madrigalet e Dranjes janë të shkruara në prozë poetike, një formë letrare kjo shumë e ndërlikuar. *Dranja* e cila ka si nëntitull *Mbi fatin e një frymori të papërsosun* është e ndarë në tre kapituj: *Përvojë jete*, *Mbrehje shqisash dhe Fryma e ngujume në asht*. E ndarë në tri cikle ajo bashkohet në një pikë të vetme, nga personazhi i Dranjës e cila është një breshkë me tipare komplekse. Poetikisht këto tri pjesë shënjojnë tri fazat e jetës së poetit. Derisa të *Përvojë jete* ne njihemi me fëmijërinë e tij dhe kujtimet e asaj kohe, të *Mbrehje shqisash*, kemi elemente të adoleshencës së tij. Pjesa *Fryma e ngujume në asht* na pasqyrohet më shumë elemente të një pjekurie të dukshme. Një shpjegim i tillë vjen nga fakti se në veprën gjejmë shumë detaje autobiografike nga vendlindja e tij ashtu edhe nga hapësirat tjera gjeografike.

Një tjetër veprë në prozë në të cilën Camaj spikat talentin e tij letrar është edhe romani *Karpa* i botuar në vitin 1987. Tërë vepra është e ndërtuar përmes figurës së parabolës. Themi kështu sepse ngjarja në roman është e vendosur në vitin 2338. Romani *Karpa*, është një ndër romanet më të veçanta në të gjithë letërsinë shqipe, pasi është ndër të rrallët që luan me elementin e kohës, me qëllimin që të pasqyrojnë më shumë gjendjen primitive të njerëzimit.

Përveç romaneve, Camaj ka shkruar edhe veprën *Shkundullima*, e cila përbëhet nga novelat: *Pishtarët e natës*, *Shkundullima*, *Rrungaja në mars*, *Katundi me gjuhë të fshehtë* dhe *Gjon Gazulli*. Ndonëse këto pesë novela janë zgjedhur prej shumë shkrimesh të Camajt për shkak të shumë karakteristikave të përbashkëta ato kanë edhe ndryshime thelbësore. Në përgjithësi këto novela paraqesin një atmosferë të vendlindjes së autorit. Vetë titujt e këtyre novelave kthejnë në jetë fjalë të vjetra të shqipes si: *shkundullima* (tërmeti) dhe *rrungaja* (orteku).

---

<sup>5</sup> Po aty, fq. 100.

### 1.3. Camaj dramaturg

Siç dihet mirëfilli fjala dramë, rrjedh nga greqishtja dhe do të thotë “veprim”. Njëkohësisht drama është i vetmi zhanër që vetëm në skenë e gjen mishërimin e saj të plotë. Në krijimtarinë e Martin Camajt zë një vend shumë të rëndësishëm edhe drama, si gjinia e tretë letrare pas poezisë dhe prozës. Ndonëse edhe jo shumë në numër, veprat dramatike të tij zënë një vend nderi në dramaturgjinë shqiptare. Camaj shkroi dy drama: *Loja e mbasdrekës* dhe *Kandili argjandit*. Këto dy drama kanë një strukturë të ngjashme, sa i përket ndërtimit tekstor dhe që të dyja i shoqëron narrativiteti. Përmes shënimeve dhe hyrjeve në kreun e çdo skene dhe pjese, në njihemi me situatën dramatike, vendin dhe gjendjen në të cilën ndodhen personazhet.

Drama *Loja e mbasdrekës* është e ndarë në dy pjesë, në prolog dhe epilog. Drama trajton disa nga arsyet pse u shtur Kanuni i Lekë Dukagjinit nga fillimi i shekullit XX. Në qendër të dramës ndodhet personazhi i Zekës, i cili personifikon kanunin dhe “mëkatet” e ardhura prej tij si një sistem i cili mbikëqyrte jetën e malësorëve. Këtu kërkohet ballafaqimi i heroit me të kaluarën dhe këto “mëkate” të tij. Drama lexohet shumë lehtësisht, mesazhi i saj përcillet qartë dhe kapet nga lexuesi edhe nëse nuk vihet në skenë.

Ndërkaq drama tjetër *Kandili i argjentit* është vepra e vetme e cila prek në mënyrë të drejtpërdrejtë realitetin shqiptar. Drama merr si objekt konkret këtë realitet duke përshkruar rrethanat e mbledhjes së arit në Shqipëri, në fillimet e sistemit komunist.

*Gjithnjë, Camën narrator e shohim, duke i përmbajtur sërish, parimit të tij për të cilin shkrimtari nuk shpall artin e vet përmes deklamacioneve dhe e ndjejmë të arrijë të bërit efekt të topikës së vet të zgjedhur, përmes tekstit dramatik, dhe jo përmes skenës.<sup>6</sup>*

## II. RRETH ROMANIT *RRATHË* TË MARTIN CAMAJT

### 2.1. Romani *Rrathë* dhe simbolika e tij

---

<sup>6</sup> Ledri Kurti, *Drama apo tekste të dramatuara: Loja e mbasdrekës dhe Kandili Argjandit* në Martin Camaj për kulturën shqiptare; shkrimtari dhe albanologu, Shkodër, 2011, fq. 36.

Ndonëse romani nuk ishte një ndër zhanret e preferuar të Martin Camajt ai me romanin *Rrathë* shprehu suksesshëm disa nga tiparet më të qenësishme të narrativës së tij. Romani *Rrathë* është vepra më voluminoze në fushën e prozës e shkrimtarit Martin Camaj. Kjo vepër i mori Camajt rreth një dekadë e gjysmë dhe në të shkriu gjithë gjenialitetin e tij prej një romansieri të pashoq, duke lënë kështu gjurmë të pashlyeshme në prozën bashkëkohore shqipe.

*Ashtu sikur tek Homeri i lashtë, Camajt vendlindja i kthehet në metonimi të atdheut, të Shqipërisë, e cila drejtpërsëdrejti nuk del thujse askund.*<sup>7</sup> Në fakt, ky roman është një prej të paktave vepra të Camajt, në të cilën ai prek në mënyrë të tërthortë realitetin bashkëkohor të Shqipërisë dhe ndryshimet emancipuese të lëvizjeve revolucionare që po ndodhnin në atë kohë. Romani është dëshmi e gjallë e një përshkrimi të këtij realiteti në të cilin individit jeton dhe zhvillohet në një rreth të caktuar shoqëror, ku çdo gjë lëviz sipas rregullit të pandryshuar.

Vepra u botua në vitin 1978 në Munih të Gjermanisë, në kohën kur Camaj jetonte atje, por atdheun e tij nuk e largonte asnjëherë nga mendja. Në këtë vepër kemi një përmasë të kohës shumë të ndërlikuar, ku kujtimi i së shkuarës dhe vizioni i së ardhmes shkrihen në një identitet të vetëm. Në vepër përmes një rrëfim - ligjërimi në prozë, i ngritur mbi vizione dhe kode rrathësh, paraqitet bota e individit në kontekstin shoqëror, përmes një strukture të ndërlikuar letrare.

*Ç'është e vërteta romani Rrathë është vepra e parë e prozës sonë, që ndërmjet artit i kundërvihet sistemit stalinist në Shqipëri në kohën kur ai kishte krijuar bazën e funksionimit dhe të ekzistimit.*<sup>8</sup> Ndonëse kjo kundërvënie është baza themelore e veprës, në sfond paraqiten edhe tema të tjera të cilat përbëjnë objektin artistik të romanit. Temat të cilat jepen si mozaik letrar në këtë vepër janë edhe fati i njeriut përballë vetmisë dhe raporti i tij me mjedisin shoqëror përreth.

Romanit i paraprinë një pjesë e titulluar *Vetje kryesore*, me të cilën Camaj e njofton lexuesin e romanit të tij me të gjitha personazhet që do marrin pjesë në ngjarjen që trajtohet aty. Kjo lloj forme e të shkruarit është tipike për pjesët dramatike, ku dramaturgu para se

---

<sup>7</sup> Shaban Sinani, *Camaj i paskajuar, Rreth tipologjisë së llojeve në veprën e Martin Camajt*, studim monografik, QSA, Tiranë, 2011, fq. 53.

<sup>8</sup> Anton Nikë Berisha, *Vepra letrare e Martin Camajt*, Botimet Princi, Tiranë, 2010, fq. 88.

të fillon zhvillimi i dramës, rishkruan të gjithë aktorët përbërës të dramës në fillim të librit. Kjo ndërthurje dhe përzierje e elementeve të formave të ndryshme të ekzistimit të artit të fjalës, dramës me romanin, është tipik për opusin e gjerë krijues të Camajt. *Dukuria Camaj ka një ndryshim thelbësor. Ai tejkalon kufijtë mes llojeve dhe nënlojeve për të fituar origjinalitetin dhe përmes origjinalitetit të sigurojë lexuesin e së ardhmes.*<sup>9</sup>

E veçanta e veprës është fakti se ajo është e konceptuar strukturalisht në tri pjesë si tre kapituj: *Rrathë Uji*, *Rrathë Zjarmi* dhe *Rrathë Gjaku*. Ndarja e veprës në tre kapituj mund të përcaktohet edhe si një lloj trilogjie nga Camaj dhe një ndarje e tillë ngërthen në vete simbolika të shumta. Një ndarje e tillë, mund ta përcaktojë edhe këtë roman si një vepër me strukturë labirintike. Treshi gjithmonë në funksione të caktuara na shfaqet si numër i shenjtë, si një numër magjik i një natyre të veçantë, jashtë përdorimit si sasi numerike e thjeshtë. Titulli i kësaj vepre letrare është bartëse e një simbolike të përgjithshme. Që në emërtimin e titujve na pasqyrohet lidhja e veprës me simbole mitologjike universale. Themi kështu sepse historikisht elementet si rrethi (rrathët), uji, zjarri, gjaku kanë qenë të ngarkuara me simbolika të caktuara. Ashtu siç shprehet me të drejtë studiuesi A. N. Berisha se kjo ndarje e romanit në tri pjesë na përkujton urtinë popullore: *Runa Zot prej ujit, zjarrit dhe pushtetit!*<sup>10</sup>

Një lexim linear mundëson që praktikisht përmes këtyre tri pjesëve të përcaktohet se rrethi paraqet kalimin e një jete të individit nëpër një sistem mjaft të ndërlikuar dhe të palëvizshëm. Një lexim të tillë e përlligj fakti se romani ka në qendër një realitet të tërthortë të Shqipërisë së asaj kohe ku individi jeton në një rreth vicioz nga i cili nuk ka si del. Fjala rreth (rrathë) shpjegohet sipas kuptimit gjuhësor, religjioz, psikologjik dhe filozofik dhe sipas këtyre aspekteve merr domethënie të ndryshme. Si gërshetim i të gjitha këtyre kuptimeve mund të theksojmë se Camaj përdor elementin e rrethit në vepër për të shënjuar fatin e pandryshuar të individit. Ashtu sikur rrathët të cilët nuk ndryshojnë kurrë formën e tyre, ashtu edhe personazhet e këtij romani kanë të njëjtin fat.

Studiuesi Shaban Sinani, vë në dukje se këta tre rrathë kanë një ndërthurje të largët me rrathët e *Nëpunësit të Pallatit të Ëndrrave* të Ismail Kadaresë. Ky mendim i tij përlligjet

---

<sup>9</sup> Shaban Sinani, *Camaj i paskajuar, Rreth tipologjisë së llojeve në veprën e Martin Camajt*, studim monografik, QSA, Tiranë, 2011, fq. 140.

<sup>10</sup> Anton Nikë Berisha, *Vepra letrare e Martin Camajt*, Botimet Princi, Tiranë, 2010, fq. 99.

me faktin se edhe në romanin e Kadaresë paraqitet realiteti i kohës dhe njerëzve të asaj kohe, prapa metaforave të nëpunësit të ëndrrave dhe interpretuesit e tyre.

## **2.2. Rrathë uji**

*Rrathë Uji* është pjesa e parë e trilogjisë së ndërtuar prej tre lloje rrathësh. Gërshetimi i simbolit të ujit dhe rrethit bashkë, jo vetëm që pasuron artistikisht veprën, por ngërthen në vetvete një simbolikë edhe më të madhe. Uji gjithmonë ka qenë simbol i pastërtisë ose i rikrijimit të botës, varësisht prej kulturave dhe besimeve të ndryshme. Varësisht prej këtyre besimeve, uji ka pasur gjithnjë edhe një simbolikë të pafundësisë, të diçkaje që nuk ka fund as fillim.

Romani fillon me shpalimin e karakterit të Folkloristit ose Bacit dhe kontaktit të tij me të dërguarit e Institutit Etnografik. Përmes narratorit, në vetën e tretë, kemi një përshkrim të shtëpisë së tij, e cila është e stërbushur me elemente folklorike. Folkloristi na paraqitet tejet i mërzhitur dhe për këtë mërzhitje ka një arsye të madhe. Sistemi kishte vendosur që të gjitha elementet tradicionale që gjendeshin në shtëpinë e tij, maskat e ndryshme, lahutat dhe gjëra të tjera, t'ia merrnin. Ndonëse ai kishte kaluar një jetë të tërë, i përkushtuar pas pasionit të folklorit dhe mbledhjes së gjërave antike, sistemi i ri ia rrënon të gjitha. Dorëzimi i të gjitha materialeve të grumbulluara gjatë gjithë jetës, për në muze shoqërohet me nota trishtuese. Për më tepër, tragjikja në jetën e tij bëhet edhe më e madhe kur tre personat e dërguar nga Instituti Etnografik, nuk i respektojnë zakonet e vjetra në shtëpinë e tij. Thyerja e këtyre zakoneve e lëndonë shpirtërisht Folkloristin, sepse ai po përjetonte një humbje të dyfishtë: kemi zbrazjen materiale të shtëpisë dhe zbehjen morale të tij nga mosrespektimi i traditave të vjetra.

Lidhja e veprës me elementet folklorike është shumë e shpërfaqur në të gjitha mënyrat e mundshme. Folkloristi si mbledhës i gojëdhënave dhe adhurues i folklorit nuk lë anash këngët dhe vargjet folklorike të cilat i shoqëron me lahutë:

*Fryma ime asht e ngujueme këtu  
Dhe sytë e mij nuk vrejnë të brishtit  
E Trajtave landore të shekullit<sup>11</sup>*

---

<sup>11</sup> Martin Camaj, *Rrathë*, Camaj-Pipa, Shkodër, 2001, fq. 13.

Toponimet gjeografike janë pjesë e pandarë e krijimtarisë letrare të Camajt. Që në fillim të këtij romani ne ndeshemi me toponiminë e quajtur *Dheu i Arbnit*. Ky toponim më shumë na paraqitet si një kujtim në retrospektivë, një realitet historik i mbetur në harresë.

Në fillim kemi vetëm një personazh kryesor që spikatet, Folkloristin, personazhet e tjerë janë karaktere dytësore ose karaktere që e plotësojnë personazhin kryesor. Vepra vazhdon me shpalosjen e personazhit të Bardhit ose Përgjegjësit dhe marrëdhëniet e tij me Nushen ose Sekretaren. Më tepër se në marrëdhënie pune, jepet marrëdhënia e tyre psikologjike, e cila është e vendosur me vite të tëra punë së bashku.

Paralel me marrëdhëniet Bardh-Nushë, na jepet edhe kontakti i parë i personazhit të Agonit me Përgjegjësin dhe njohja e tyre. Bardhi ishte në krye të sistemit kurse Agoni, bashkëpunëtori i ri në rubrikën kulturore, me profesion agronom e me pasion të letërsisë e shkrimeve në zemër. Fjalët e Bardhit, e ngacmojnë vetëdijen e Agonit lidhur me procesin e shkrimit: *Ide të vlefshme për njerëzit tanë, ide të reja! Si shkrimtar po thom, truni yt duhet të pjellë ide këso lloji.*<sup>12</sup>

Bardhi e cakton pikërisht Agonin që të shkojë në Rripën e Mesme, në vendin e tij të lindjes, që të hetonte rreth Ilegalit. Mirëpo, sipas shkresave zyrtare, Agoni do të shkonte atje që të kontrollonte dhe të vëzhgonte nga afër hyrjen e traktorëve në Rripën e Mesme. Meqenëse ishte prozator, Agoni patjetër që duhej të bënte një artikull “të denjë” për këtë ngjarje kaq madhështore për rripasit.

Ndërkohë që u caktua të shkonte në Rripë, Novelisti kishte në mendje të takonte atje edhe ish-të dashurën e tij, Zojen, për të cilën ende kishte ndjenja. Kulmi ndaj këtyre ndjenjave shpërfaqet në rastin kur ai vendos që të qëndrojë në shtëpinë e gjyshes së saj, të cilën Agoni e quan me emrin Roja e Shtëpisë, në mënyrë që të zbulonte zanafillën e jetës së saj.

Paralelisht me udhëtimin e Agonit për në Rripë na paraqitet edhe personazhi i Drenashit apo Fetarit. Më tepër se në përshkrim të jashtëm, personazhi i Drenashit na paraqitet gjithnjë në mëdyshje për jetën dhe kontaktet me vëllanë e tij, Bardhin. Meqenëse Bardhi ishte në krye të sistemit të ri, dosido që kishte probleme edhe me Drenashin, pasi ai ishte njeri fetar. Ndodh kështu sepse sistemi i ri, nuk ishte mbështetës i fesë. Ne e njohim personazhin e Drenashit edhe përmes takimit që ka ai me Folkloristin të cilin e kishte pasur

---

<sup>12</sup> Po aty, fq. 41.



dikur mësues. Biseda e tyre, na shpërfaq shumë tipare të letërsisë, duke qenë se ata i bëjnë një analizë të thuktë romantizmit shqiptar dhe atij evropian, duke vënë në dukje të përbashkëtat dhe të veçantat e tyre. Aty-këtu ata citojnë edhe ndonjë thënie të ndonjë shkrimtari, pa ia ditur autorësinë e vërtetë:

*Çka janë këto flegrimet e vuejtjet tua? Eja e shih*

*Qiparizat, ndëgjo hutinin e çeli shteg vetës*

*Tue ecë, heu, mbi throne e tempuj të rrëzuem.*

*Agonia e tyne asht rreziku i sodit-shih*

*Botën para kambëve tona të brishtë si kufomë!<sup>13</sup>*

Udhëtimi i Agonit për në Rripë shoqërohet gjatë gjithë kohës me shi. Këtu na paraqitet imazhi i parë i rrathëve të ujit, në qytetin verior. Imazhi i dytë i rrathëve të ujit na paraqitet në lumin e fshatit të Rripës së Mesme. Pjesa *Rrathë Uji* përfundon pikërisht me një përshkrim të detajuar të këtij udhëtimin të Agonit për në Rripën e Mesme, udhëtim ky që, aq sa e entuziazmon, aq edhe e trishton. Shiu dhe balta të cilat e përcjellin gjatë gjithë kohës, lidhen me jetën të cilën ai e jeton. Ky udhëtim, është edhe një lloj udhëtimi simbolik i Agonit në ëndrrat e veta, në shtigjet e një jetë të izoluar, të cilën duhet ta jetojë me frikë të sistemit mbi kokë.

### **2.3. Rrathë zjarmi**

Menjëherë si të përmendet zjarri, të bie ndër mend Prometeu, i cili u rrëmbeu zjarrin perëndive dhe ua dha njerëzve, që me anë të zjarrit qytetërimi të ecte përpara. Gërshetimi i zjarrit dhe rrethit në pjesën e dytë të romanit ngërthen një simbolikë edhe më të madhe. Agni ka qenë perëndi e zjarrit te Indusët në Indi. Se a është ngjashmëria e emrit të këtij perëndie me emrin e njërit prej personazheve kyçe të romanit, Agonit; vetëm rastësi apo zgjedhje e qëllimshme nga Camaj mbetet një pyetje hipotetike dhe pa përgjigje. Zjarri në kultura dhe besime të ndryshme ka qenë ose simbol i ripërtëritjes së jetës, ose thjesht një botë flakësh e papërballueshme për qeniet e gjalla.

---

<sup>13</sup> Po aty, fq. 71.

Në kapitullin e dytë, Camaj është fokusuar më shumë te përshkrimi i toponimeve gjeografike. Përshkrimi i Rripës së Mesme, Rripës së Epërme dhe Rripës së Lartë bëhet deri në detajet më të hollësishme. Rripasit si banorë të këtyre anëve, përshkruhen me të gjitha traditat e tyre, duke filluar nga paja e nuses e gjëra të tjera tradicionale. Një vend të rëndësishëm zë edhe përshkrimi i gjuhës së rripasve me të gjitha ndryshimet thelbësore mes tyre. *Nuk bien në sy ndryshimet ligjëruese mes Rripës së Epërme e të Mesme. Marrë si tanësi, kjo quhet e folmja e brijave të malit' dhe si tip o kundërvëhet asaj të Rripës së Poshtme e cila thonë se tingëllon ma ambël se gjuha e malësorëve.*<sup>14</sup> Përveç përshkrimit të Rripës, ne ndeshemi edhe me toponimin e quajtur Qytecë, vend mes malesh, si një lloj qyteti-kështjellë, ku takohen dhe zë fill kontakti i parë i Agonit me Folkloristin. Qyteca më shumë na del si një vend imagjinar, jo real, diçka që ekziston vetëm në mendjen e Agonit.

Momenti kyç i romanit *Rrathë*, është kur Agoni shpëton Sosën, të bijën e virgjër të Rapsodit, nga përdhunimi i Cubit. Paraprakisht, ai ngelet i befasuar nga figura e Sosës dhe bukuria përrallore e saj. Pikërisht, këtu zë fill e zhvillohet dashuria e tij për të. Sosja ka një bukuri mahnitëse por në sytë e njerëzve është thjesht një e çmendur. Këtë mendim e kanë edhe për faktin se ajo është e rritur me legjenda mbi Zana e Orësh mali, dhe si e tillë ka shumë karakteristika të tyre. Disa nga këto karakteristika janë: të folurit e saj me hiperbola dhe endja e saj vetëm në kreshtat e malit natën.

Në shtëpinë e Folkloristit zhvillohet sipas riteve tradicionale festimi i zbritjes së bagëtisë nga bjeshkët, një ngjarje kjo kulmore në jetën e fshatarëve. Aty marrin pjesë edhe Agoni dhe Rapsodi, dhe shumë banorë të tjerë. Darka pasi zhvillohej në shtëpinë e Folkloristit, dosido është e mbushur me elemente tradicionale, me këngë folklorike të shoqëruara me lahutë dhe gojëdhëna të moçme. Në këtë darkë shpërfaqet më së miri edhe konflikti mes dy gjeneratash, mes të rinjve dhe të moshuarve dhe mospajtimet e tyre. Një nga arsyet e këtij konflikti është pikërisht figura komplekse e Sosës. Deri sa të moshuarit e shohin atë si vajzën e shndërruar prej Orëve të malit qysh në djep, pra i japin asaj karakter mitologjik, të rinjtë e shohin atë thjesht si një të marrë dhe të çmendur. *Një palë burrash që beson në qenës të mbinatyrshëm, domethënë bestytësit, e mbajnë vajzën të shndërrueme prej Orësh qysh në djep, ndërsa të arsimuemit, breznia e re, thonë se ajo paska rremb*

---

<sup>14</sup> Po aty, fq. 97.

*marrie. Të dy palët shohin në vetjen e saj femnën që përlyen e sjell vetëm fatkeqësi.*<sup>15</sup> Këtu na del edhe se besimi i përgjithshëm në Orët dhe Zanat e malit, është një konflikti mes dy gjeneratash, mes të rinjve dhe të moshuarve.

Gjatë qëndrimit në Qytecë, në qytetin-kështjellë, Agoni njihet dhe përballet me personazhe të ndryshme. Zbritja e tij nga Qyteca në Rripën e Mesme, shoqërohet me ngarkesa të theksuara psikologjike të mendjes së tij. Mendimi për Sosen, gruan-zanë, nuk e lë të qetë asnjëherë. Paralel me mendimet për të dyzohen edhe mendimet për Zojën, ish-të dashurën e tij.

Narratori na njofton edhe me një varg personazhesh të tjerë, fati i të cilëve nuk ndërlihet në asnjë formë me fatin e Agonit. Mbetet në mendjen e lexuesit, sidomos personazhi i Zoges. Ajo personifikon tipin e gruas së guximshme, e cila që të mos e humbas rrënjën e familjes, vendos të vishet si burrë dhe të mos martohet.

Pritja e traktorëve në Rripën e Mesme nuk e kishte atë entuziazmin që sistemi priste ta kishte. Për këtë shkak, edhe Bardhi, përgjegjësi i sistemit, vendos të shkojë atje dhe ta ndjek nga afër këtë ngjarje të shënuar për të. Ceremonia e zbarkimit të traktorëve në Rripën e Mesme, vonohet disa ditë dhe askush nuk e dinte arsyen pse. Kjo ngjall dyshime te Bardhi, i cili edhe ashtu ishte shumë i zemëruar. Në mesin e banorëve rripas, kishte parë edhe vëllanë Drenashin, ndaj të cilit ndiente urrejtje. *S'e kam mendën atje,- përgjegji Bardhi tue shënue me gisht Drenashin-por tek ai idioti atje! Kisha me t'u lutë për një nderë: fol me përgjegjës përkatës edhe prej anës sime e le ta largojnë këndeje. Thueju ta kufizojnë në ndonjë trevë ku s'e njuh kush, larg këndeje!*<sup>16</sup> Pra, Bardhi kërkon një hapësirë gjeografike tjetër për vëllanë e tij, sepse ai ishte ndryshe nga njerëzit e tjerë.

Zjarri paraqitet disa herë si sekuenca të shkëputura në roman. Imazhi i parë i zjarrit na paraqitet, pikërisht në shtëpinë e Folkloristit, natën kur po festonin të gjithë. Zjarri në pjesë e dytë, na del si trajtë bashkimi, pranë tij janë mbledhur i ri e i vjetër duke kuvenduar. *Ndërkaq darka kish mbarue dhe në rrethin e zjarrit ku kishin zanë vend Folkloristi e Rapsod, filloi pija e venës.*<sup>17</sup>

---

<sup>15</sup> Po aty, fq. 141.

<sup>16</sup> Po aty, fq. 197.

<sup>17</sup> Po aty, fq. 151.

*Rrathë zjarmi* përfundon me arritjen e traktorëve në Rripën e Mesme. Me rrathët e zjarrit, Camaj simbolizon më së miri zjarrin ose rrezikun në të cilën gjendeshin personazhet e tij, të cilët jetonin sipas parimeve të sistemit të kohës.

#### **2.4. Rrathë gjaku**

Gjaku një tjetër simbolikë shumë domethënëse në veprën e Camajt merr një dimension shumë artistik në pjesën e tretë të romanit *Rrathë*. Nëse synohet të shprehet me pak fjalë impresionimi që kanë fëmijët rripas për arritjen e traktorëve në qytetin e tyre, është me vend t'i sjellim këngët të cilët ata i këndojnë para kësaj ngjarje të rëndësishme për ta:

*Po vjen kumbara-me rrotë përpara!*

*Po vjen ndrikulla -me një kupë petulla!<sup>18</sup>*

Me gjithë pritjet e sistemit, kjo ngjarje nuk merr simpatinë e duhur të banorëve rripas, dhe mu për këtë Agoni shkarkohet nga puna. Kjo i sjellë qetësi shpirtërore atij, sepse tash i vetëm shkon ndër male, në Qytecë ku kalon një pjesë të madhe të jetës.

Në qytetin kështjellë, Qytecë, Agoni has në disa imazhe gjaku, prej nga edhe emërtohet pjesa e tretë e veprës. Imazhi i parë i gjakut është tek njollat e gjakut që has në një përleshje të fëmijëve rripas në mbrëmje. *Mue më ka bërë përshypje gjaku i një fëmije.<sup>19</sup>*

Imazhi i dytë i gjakut, shfaqet nga dialogu i tij me Folkloristin dhe mburrjet e këtij të fundit për traditën e lashtë të epikës popullore qysh nga Homeri. Folkloristi thekson se diku në *Odise*, Homeri vë në dyshim edhe besën e Penelopës kur thoshte: *Po e di se gjaku ndërron në prazëm të grues.<sup>20</sup>*

Imazhi i tretë i gjakut, i cili është edhe më simbolik, na shfaqet në një kishë të një sektit ilegal në Rripën e Poshtme, ku besimtarët vetëfliohen në mënyra drastike. Romani vazhdon me pasazhe të shtegtimit të përbashkëta në male të Agonit me Sosen. Por rrjedha e jetës së tyre, ndryshon kur Agoni, i cili dikur e kishte shpëtuar nga përdhunimi, e bën këtë akt vetë mbi Sosen. Kjo pasi, Agoni kishte kërkuar paraprakisht që të iknin diku larg,

---

<sup>18</sup> Po aty, fq. 200.

<sup>19</sup> Po aty, fq. 238.

<sup>20</sup> Po aty, fq. 239.

por Sosja e kishte refuzuar duke i thënë: *E si t'i zhgulë unë rranjët këndeje*<sup>21</sup>? Këtu shpërfaqet më së miri lidhja shpirtërore e figurës së Soses me vendlindjen e saj. Agoni dëbohet nga vendi, pikërisht nga Delmari, sepse ai kishte parë aktin e tmerrshëm. Më këtë largim, Agoni humb edhe kuptimin e kohës dhe të hapësirës. Tragjikja e vërtetë nuk është ndalimi i lëvizjes nëpër Ripë, por vetmia që e rrethon me largimin e Soses. Kështu, vitet e tjera, ai jeton një jetë krejtësisht i vetmuar. Nuk e ka idenë se si ikin vitet, ai është i mbërthyer në kulmin e vetmisë, si një lloj dënimi për atë që kishte bërë. Qortohet përsëri nga sistemi, përmes Yllit, i cili tash ishte në vendin e Bardhit. Qortimi ndodh për shkak se në teatrin e kukullave do të shfaqej një dramë, e cila ishte e mbështetur në novelën e tij *Shtëpia përtej malit*. Në qytet takon Sosën e cila tash po punonte si shitëse në teatrin e kukullave. Kupton se pikërisht, djali i saj, kishte qenë regjisor i dramës e cila ishte mbështetur mbi novelën e Agonit.

Agoni nuk është personi që e kërkonte vetminë, por për shkak të veprimtimit që bën, detyrohet që të rrijë larg vajzës që do dhe larg pasionit për shkrimin. Vetmia i sjellë atij edhe absurdin e jetës. Ai humb edhe kuptimin e kohës, duke jetuar në vetmi, mbyllur në një hapësirë, për njëzet vite, pa e kuptuar as vetë këtë ndryshim kohor kaq të madh. Me personazhin e tij dhe fatin e keq që pëson Camaj paraqet në një formë ose tjetrën fatin e shkrimtarit në një sistem të rreptë shoqëror. Fatin e këtij shkrimtari na paraqet edhe përmes një personazhi tjetër, i cili paraqitet në disa pasazhe të romanit, i quajtur Markoci, njeriu racional dhe i arsyeshëm, që shkruan ashtu si donë të tjerët.

Kështu përfundojnë ngjarjet subjektore në romanin *Rrathë*, ku shumica e këtyre ngjarjeve nuk i nënshtrohen kushtëzimit kronologjik të subjektit. *Veprën Rrathë të cilën studiuesit e njohin dhe si roman të karaktereve, roman psikologjik (madje edhe romani i parë psikologjik shqiptar), roman palmipsest, por edhe roman nihilist, një aludim për antiromanin, shkrimtari vetë e ka ndërtuar mbështetur mbi një prej formave më të hershme të rrëfimit, mbi shëmbëlltyrën, siç është në traditën e shkrimeve ungjillore.*<sup>22</sup>

### III. PERSONAZHET DHE GJUHA

---

<sup>21</sup> Po aty, fq. 287.

<sup>22</sup> Shaban Sinani, *Camaj i paskajuar, Rreth tipologjisë së llojeve në veprën e Martin Camajt*, studim monografik, QSA, Tiranë, 2011, fq. 123.

### 3.1. Diskursi i personazheve

Camaj përdor lloje të ndryshme të karaktereve në romanin *Rrathë*, të cilat përmbushin role të caktuara në procesin e rrëfimit. Personazhet që na paraqiten në vepër nuk janë heronj mitologjik, as shëmbëlltyra kanunore, por as personazhe që bartin ngarkesa didaktike e moralizuese. *Në Rrathë trajtohet veçanërisht bota e ndërliqshme dhe e pasur e individit; depërtohet thellë në dramën e mbrendshme të tij, në ndjesitë dhe në shqetësimet, në dëshirat dhe synimet.*<sup>23</sup>

Një prej funksioneve më të rëndësishme letrare të elementeve të tekstit në prozë lidhet shumë ngushtë me përshkrimin e botës së personazheve. Personazhet janë ato që përjetësojnë rrëfimin artistik në veprën letrare. Për këtë arsye Camaj në romanin *Rrathë* (por edhe në proza të tjera) zgjedh personazhet mjaft të veçantë dhe i skalit ata me mjeshtëri të rrallë. Përzgjedhja e emrave të personazheve dhe mentaliteti i tyre shpërfaqin më së miri identitetin e vendlindjes së tij. Kjo përzgjedhje e emrave të personazheve nuk bëhet rastësisht. Emërtimi i personazheve bëhet për qëllime artistike, që veprës t'i japë edhe më shumë përjetësim artistik të realitetit shqiptar. Ndonëse Camaj kishte kontakt të vazhdueshëm me kulturën dhe letërsinë evropiane perëndimore dhe si i tillë kishte shumë mundësi që personazhet e tij t'i pagëzonte me emra shumë modern ai nuk u largua nga zanafilla e rrënjëve të veta as në këtë aspekt.

Veçanësia e këtyre personazheve të romanit qëndron te fakti se ata na paraqiten përgjithësisht si me emrat përkatës të tyre, ashtu edhe me emërtimet tipike të funksionit që kryejnë. Fjala vjen, Bardhi ka emërtimin tipik të funksionit që kryen dhe në roman na del i emërtuar edhe si Përgjegjësi. Folkloristi na del me emërtimin e Bacit, kurse Agoni është thjesht Novelisiti, emërtim ky tipik për një prozator si ai. Sosja ka emërtimin edhe si Vajtorja, sepse herën e parë në takim me Agonin, kishte qenë duke vajtuar te varrezat. Agoni madje e quan atë edhe Blegë, që të mendonte se para tij paraqitet dikush tjetër. Edhe personazhet tjera, ndonëse episodike, kanë emërtime të tilla, varësisht nga funksioni që kryejnë. Një dukuri e tillë, ku personazhet na paraqiten me dy emra (në disa raste edhe me tre) lidhet në një mënyrë ose tjetrën edhe me një tendencë të paraqitjes së dyfytërsisë së pushtetit të kohës.

---

<sup>23</sup> Anton Nikë Berisha, *Vepra letrare e Martin Camajt*, Botimet Princi, Tiranë, 2010, fq. 90.

Personazhi i cili lidh tre rrathët apo kapitujt e veprës është një nyje e rëndësishme në të cilën zë fill e zhvillohet ngjarja. *Ai quhej Bardhi dhe emnin ia kishin ndëgjue i madh e i vogël në atë qytet.*<sup>24</sup> As te personazhi i Bardhit, Camaj nuk e ka shmangur teknikën e dyemërsisë. Ai na del si i ashtuquajtur Përgjegjësi, duke përshkruar me anë të këtij emri, funksionin themelor që kishte. Roli dhe rëndësia e tij përlijen edhe me shprehjen e narratorit: *askush nuk e përmend emrin e tij, ndonëse secili e ka një emën për të.*<sup>25</sup> Bardhi del si personazhi kryesor që është shumë i vendosur ta mbështesë sistemin e ri dhe të bëhet mbështetësi më i madh i këtij sistemi. Madje, duke mos cenuar parimet e këtij sistemi ai është në gjendje të cenoi edhe jetën e familjarëve të tij. Kujtojmë këtu rastin, kur kërkon që Drenashin ta largonin diku shumë larg, vetëm pse ishte njeri fetar.

Personazhi i Folkloristit apo Bacit mishëron më së miri lidhjen e Camajt me traditën e pasur folklorike. Me personazhin e tij Camaj ka arritur të ndërtojë një përfaqësues shumë të mirë të gjeneratës së vjetër, i cili mbron me të drejtë shumë rite dhe zakone të vjetra shqiptare. Camaj e paraqet atë si shumë të lidhur me fëmijërinë, paraardhësit, sendet, objektet e trashëguara e të mbledhura gjatë gjithë jetës. Duket sikur në karakterin e Folkloristit autori është aty, po aq sa është edhe i shkrirë me karakteristikat e tij, me ëndrrat e tij dhe përpjekjet e tij të mos harrohen gjërat tradicionale. Paralel me personazhin e Folkloristit zhvillohet edhe personazhi i Rapsodit. Ata të dy, duket sikur e zbulojnë njëri-tjetrin, por edhe vetveten.

Te personazhi i Agonit apo Novelistit, një prozatori të pashoq të kohës, gjejmë të mishëruar njeriun i cili kur ballafaqohet me realitetin ku jeton, ka shumë mospajtime dhe pakënaqësi, por prapë nuk e ka guxim të rebelohet. Themi kështu sepse, ndonëse shkrimet e tij lidhur me çështjet themelore të artit, censurohen ose ndryshohen, ai hesht dhe s'ka guxim ta shpreh revoltën hapur. Revolta e tij ndaj këtij fenomeni na del më shumë si revoltë psikologjike, si një luftë mes mendjes së tij dhe sistemit të kohës. Camaj e ndërton personazhin e Agonit si një personazh pasiv të dobët, si një personifikim të masës popullore shqiptare e cila jeton në një rreth shoqëror nga i cili nuk dalin kurrë. Agoni mishëron njeriun që sakrifikon edhe dashurinë para epshit të tij mashkullor. Kujtojmë këtu përdhunimin që ia bën Soses, vajzës që e dashuronte aq shumë.

---

<sup>24</sup> Martin Camaj, *Rrathë*, Camaj-Pipa, Shkodër, 2001, fq. 21.

<sup>25</sup> Po aty, fq. 22.

Personazhi me emrin Sose, ka një diskurs përrallor të tipit përshkrues. Personazhi i Soses është figura më komplekse dhe më e çuditshme e romanit *Rrathë*. Këtë mendim e përlligj fakti se ajo është një personazh që qëndron mes kufirit të realitetit me imagjinatën, mes të zakonshmes dhe të mbinatyrshmes. Veçanësia tjetër e saj lidhet me faktin se ajo na paraqitet në momentet më të rëndësishme të romanit *Rrathë*, duke u bërë faktori kyç pse Novelisti e vë në skenë dramën e tij. Sosja është personifikim i gruas tradicionale shqiptare, e cila jeton një jetë shumë të varfër dhe është krejtësisht e pashkolluar. Madhështia e figurës së saj rritet edhe më shumë kur ajo, ndonëse është e vetme në jetë, ka guximin femëror t'i kundërshtojë meshkujt që e shohin atë vetëm si objekt seksual.

Te romani *Rrathë* marrëdhënia Agon-Sose, është një lloj qasje dramatike dhe një lloj përshkrimi jo i zakonshëm i kultit të zakonshëm të dashurisë. Sosja bëhet muza e cila e frymëzon Agonin për artin letrar. Madje, ajo bëhet edhe shkak kryesor pse Agoni e vë në skenë dramën e tij. Agoni është figura më paradoksale e romanit *Rrathë*. Derisa dikur vetë, e kishte shpëtuar Sosen nga përdhunimi i Cubit, kohë më pas, ai bëhet protagonist i këtij akti të tmerrshëm.

Personazhe të tjerë që kanë tipare mitike janë edhe Rapsodi dhe Drenashi. Në këtë mes shquhet sidomos Drenashi, i cili personifikon tipin fetar, që nuk e kursen as jetën e vet për vetëflijim në atë që besonte. Ai ishte themelues i një sekti fetar, sekt ky që në thelb ka sakrificën dhe përshkruhet me hollësi përmes narratorit.

Zoga është një arketip i gruas shqiptare që synon ta ruaj traditën e familjes duke mos u martuar. Zoga është figurë paradoksale, ajo ndonëse ka vendosur të mos martohet dhe të jetoj si e virgjër, në realitet nuk është e tillë. Ka lidhje të fshehtë me Leshkuqin, dhe si e tillë, preteksti se po ruante traditën e familjes është vetëm një maskim i pashoq.

Gjyshen ose Rojën e Shtëpisë narratori na e përshkruan si një personazh pasiv, si një grua plakë, që qëndron e përqafuar me vetminë dhe e pret pa frikë aktin e vdekjes. Ndonëse kemi edhe personazhe të tjerë episodike, ata nuk arrijnë të spikaten mirë si karaktere dhe personalitete të theksuara. Ata thjesht mbesin si imazhe të cilët lexuesi e ka të vështirë t'i identifikojë qartë.

Personazhet e romanit *Rrathë* janë një botë unike, që paraqet një realitet nga bota e jashtme. Përmes tyre reflektohet bota psikologjike dhe brendia e njerëzve të cilët jetojnë në një sistem të ngulfatur. Ata, ndonëse nuk janë në asnjë konflikt të hapur me sistemin



përreth, ndihen në çdo aspekt të humbur. Përmes formave të ndryshme kërkojnë të gjejnë vetën e tyre në këtë sistem, të ndihen të lirë dhe të rëndësishëm. Si personazhe që janë marrë nga ambienti dhe bota shqiptare, personazhet e këtij romani bartin ngarkesa të theksuara emocionale dhe psikologjike meqenëse paraqesin njeriun shqiptar, i cili përballlet me sistemin e kohës. Duke qenë se Camaj njihje relativisht mirë vendlindjen e tij, ai arrin të përshkruaj shumë mirë galerinë e këtyre njerëzve me të gjitha vuajtjet, peripecitë dhe tragjikën në jetën e tyre.

Të gjitha këto veçori të personazheve ne i marrim përmes dialogut që kanë ata ndërmjet veti dhe formave të tjera ligjëruese. Zëri narrativ është zëri i cili ndërmjetëson që lexuesi të deportojë thellë në psikologjinë e personazheve të romanit *Rrathë*. Narratori ndonëse është në vetën e tretë, është shumë i shkrirë në botën e personazheve, sidomos te personazhi i Agonit. Prania e narratorit, nuk ka thjesht karakter teorik, ai është me tepër se një funksionar i llojit, është bashkëpjesëmarrës në ngjarje. Prania e tij, ndihet kudo madje edhe në rastin kur i drejtohet lexuesit, sikur janë afër njëri-tjetrit. *Ngjarja që ndjek, lexues, vërteton se ka andrra e andërrime që lidhen përnjëherë në vend e pa vonesë me njëmendësinë.*<sup>26</sup> Madje ka raste kur narratori e përcakton shkallën e kuptimshmërisë që ka lexuesi i romanit. *Lexuesi sigurisht e ka vu ore se Novelisti ynë i përkiste këtij breznie e cila kishte qëndrim të caktuem edhe për sa i përket shijimit të ngjyrës së sendeve.*<sup>27</sup> Rasti më i veçantë i pranisë së lexuesit në vepër, është kur narratori, jep arsyetim përpara tij (lexuesit) se përse po e mbyllte rrëfimin. *Treguesi po e ndërpret rrëfimin mbi Zogën dhe po e lën dritaren në dritarën e një mëngjesi të ri përballë Rripës.*<sup>28</sup>

Edhe mënyra se si lidhen personazhet në këtë roman, është mjaft e pazakontë. Ata nuk janë as të një familje, as i lidh ndonjë konflikt i hapur me njëri-tjetrin. Ata lidhen me fije të pashpjegueshme: janë pjesë e të njëjtit sistem dhe çdo ditë përballen me rrathët e këtij sistemi. Drama në jetën e tyre është e përbashkëta e tyre, ata bashkohen në sfidat që ka vënë pushteti i ri mbi kokat e tyre.

Vetmia si një zgjedhje që kanë bërë personazhet e romanit *Rrathë* si: Agoni, Bardhi, Drenashi, Folklorisiti, në procesin letrar shërben si maskim i motiveve se si duhet të reagojë

---

<sup>26</sup> Po aty, fq. 158.

<sup>27</sup> Po aty, fq. 160.

<sup>28</sup> Po aty, fq. 216.

njeriu në situata të tilla, të cilat janë shumë komplekse. Të gjitha këto veçori të personazheve në i marrim përmes psiko-narracionit, si teknikë letrare, e cila është përdorur në shumë raste, por më së shumti si një lloj paraqitje e karakterit të personazheve. Të gjitha këto personazhe janë tipizime të plota të një shtrese të caktuar të shoqërisë së kohës.

### 3.2. Pasuri gjuhësore

Martin Camaj është shembulli më i mirë i shkrirjes së punës letrare me atë të fushës gjuhësore. Themi kështu sepse ai përdori në të gjitha tekstet e tij, qofshin edhe ato studimore dialektin e gegërishtes. Këtu qëndron edhe merita dhe vlera më e madhe e tij si shkrimtar, sepse nëpërmjet letërsisë ai e afron lexuesin shqiptar me trajtat dialektore të vendlindjes së tij, me të cilat shkruan edhe Gjon Buzuku, Frang Bardhi, Pjetër Bogdani, Pjetër Budi, Ndre Mjeda, Gjergj Fishta, Filip Shiroka, Arshi Pipa dhe Ernest Koliqi. Camaj nuk shkroi në trajtat nëndialektore, sepse ishte i vetëdijshëm se kjo gjë do ta vështirësonte shumë leximin e veprave të tij, prandaj përdor një gegërishte mjaft të avancuar letrare.

Edhe romani *Rrathë* është i shkruar me të njëjtin sistem gjuhësor. Kështu Camaj thyen “mitin e vjetër” se gegërishtja është vetëm gjuhë poezie. Elementi gjuhësor te Martin Camaj dhe romani *Rrathë*, përbën fushë të veçantë studimore sidomos në rrafshin gramatikor dhe leksikor. Çka e bënë edhe më të veçantë këtë vepër është fakti se ajo është jashtëzakonisht e pasur me fjalë arkaike,<sup>29</sup> njësi frazeologjike<sup>30</sup> si dy elemente që spikasin nivelin e lartë gjuhësor të kësaj veprë letrare.

Camaj u pri që në të gjitha veprat e tij letrare të shkruara në prozë, të përdorte dendur njësitë frazeologjike, që veprës t’i jepte edhe me shumë shpirt nga traditat e atdheut të tij. Këto njësi frazeologjike ndonëse i hasim në të gjitha veprat e Camajt, gjenden të përdorura më dendur në romanin *Rrathë*, ndoshta edhe për shkak të madhësisë vëllimore të tij. Thujse gjithë këto njësi frazeologjike përdoren si një lloj ironie në dialog me personazhet e tjera të romanit. Do t’i japim më poshtë disa nga njësitë frazeologjike që kemi hasur në gjatë leximit të romanit:

---

<sup>29</sup> Fjalët që janë vjetruar a po vjetrohen dhe për këtë arsye kanë dalë ose po dalin nga përdorimi, kalojnë nga shtresa aktive në shtresën pasive të gjuhës.

<sup>30</sup> Njësia frazeologjike është njësi gjuhësore me kuptim të mëvetësishëm, e përbërë nga dy ose më shumë fjalë shënjuese (emërtuese), me gjymtyrë e ndërtim të qëndrueshëm, e formuar historikisht e për një kohë të gjatë, që ka vlerën e një fjale të vetme, riprodhohet në ligjërim si njësi e gatshme dhe funksionon në gjuhë si njësi e pandashme.

*Ujku don mish, i thonë një fjale të lashtë.  
Pse doni ta bani mizën buell apo për një plesht doni ta digjni jorganin?  
Përgjegjësi u ndej gati e u tha se duheshin shti veshët në lesh e do të shihej se kështu me një të rame vriteshin dy miza.  
Dhe sikur të befasohen, u vjen turp si me i zanë me presh në dorë tue vjedhë.  
Në thelb Bardhi e shokët e tij arsyetonin shumë thjeshtë: kur s'ec fjala, duhej me u ra lodrave e topave që bota të pyesë, çka janë krismat.  
Gjak në sy më ka!  
Mos na qit syve hi!  
Ai papandehun tretet si spata pa bisht.  
Përziu lesh e li mes tyne, periudha e rryma letrare.  
Çdo popull ka asish e kësish.  
Ai që i rrin mollës për nën, i ha kokrrat!  
Fjala jote në vesh të grave të bukura!  
Po ujku lind pakëz i pëthimë.  
Edhe gjurma bëhet ujk!  
Sepse nuk kam pasë punë atje ku çel dreqi zogj.  
Ata të Qytecës, meqenëse kanë punë pak dhe për këtë s'ka se çka u ha mini mbas darke, për të qitë kangë e përralla u del mot mjaftë.  
Kush flen me qen, çohet në nadjë me pleshta!  
Mali për mal përpiqet!  
I cofën morrat në trup!  
Ndiente se periudha e re tue lindë shënonte edhe sosjen e botës përrallëzore për të cilën ishte lidhë si thoni për mish.  
Prej meje nuk nxjerr asnjë fjalë edhe po të bahet dhami sa lisi.  
Rinia e di rrugën e vet-qeni plak gjuhëtar s'bëhet!  
Si të jetë vendi bëhet kuvendi.  
Ai kangën në fjalë e kishte lexue në një libër të një shkrimtari që Baci e njihte dhe kish ngranë si thotë një shprehje hiperbolike popullore, nje thes krypë me të.  
Pleqnisë ia la fajin e jo sistemit sundues e njerëzve të fuqishëm që dinin të shtinin edhe dreqin në kungull.*

*Për këtë i dukeshin Agonit të vjetri si laknori me shumë petë.  
Dasma dasmë dhe morti mort!  
Kudo rafsha-mos u vrafsha!  
Tha Agoni të cilit fjalët e Bacit i hynë në një vesh e i dolën në tjetrin.  
Baci shtiu veshët në lesh e ndërroi kuvend.  
Në aso dërrasash të kalbëta nuk shkel unë!  
Paska ardhë lëkura e harushës!  
S'ke çfarë t'i bësh: dasmë pa mish nuk ka!  
Donë me na lanë të dyve kopilin te dera.  
Por folësit nga qendra i dogji miza.  
I duhen pre drutë shkurt.  
Dasmë pa mish nuk ka!  
Mos qitë petulla në hi e dokrra në ujë.  
I durueshëm filan filani, e zë lepurin me qerre.  
Thonë vetëm: i mjeri ai të cilit i hangri shpina dhe!  
Kisha frikë se humbas si sëpata pa bisht në atë mori njerëzish.  
Njëqind urti e një trimni!<sup>31</sup>*

Siç mund të vërehet në shembujt e mësipërm, denduria e përdorimit të njësive frazeologjike në romanin *Rrathë* është shumë e madhe. Në disa prej këtyre shembujve, vërehet ndërputja e elementeve që nuk janë pjesë e njësisë frazeologjike duke treguar një qëndrueshmëri jo të lartë të saj. Duke vështruar njësitë frazeologjike si në shumësinë ashtu edhe në dendurinë e praninë, vijmë në përfundim se kryesisht ato kanë rolin kyç në karakterizimin e personazheve. Fjala vjen, Folklorisiti ose Baci është personazhi që shquhet më së shumti në përdorimin e tyre. Nga kuptimet e figurshme të këtyre njësive frazeologjike mund të përcaktohet nga njohuritë konceptore që ato kanë në bazë metaforën. Rëndësia e studimit të njësive frazeologjike në këtë roman qëndron jo vetëm për sa i përket anës formale dhe semantike të saj por për zbulimin e disa perceptimeve të rëndësishme për lidhjen ndërmjet gjuhës dhe të menduarit të personazheve.

---

<sup>31</sup> Që të mos e rëndojmë temën me fusnota të panevojshme: Të gjithë shembujt janë marrë nga: Martin Camaj, *Rrathë*, Camaj-Pipa, Shkodër, 2001, fq. 23-283.

Duke studiuar sistemin gjuhësor të romani *Rrathë* patjetër që të bie në sy një fenomen të cilin po e sjellim në vëmendje. Është fjala për dendësinë e përdorimit të fjalëve arkaike në vepër. Siç e pamë, fjalori i Camajt është shumë i pasur. Jo vetëm me njësi frazeologjike por ai pasuron sistemin e tij gjuhësor me shumë fjalë që përdoren shumë rrallë, ose nuk përdoren fare. Lexuesi tash e ka të lehtë t'i identifikojë këto fjalë, sepse në fund të librit, jep një *fjalorth* më afro 300 fjalë, duke shpjeguar kuptimin e tyre. Kështu Camaj nuk ka nevojë ta himnizoj gjuhën shqipe, duke i kushtuar poezi ose vepra, ai përmes gjuhës që përdor e ngrit në arealin më të lartë të mundshëm atë.

Gjithë panoramës së mësipërme të sistemit gjuhësor të romanit *Rrathë* i shtohet edhe prania e urimeve, mallkimeve dhe formulave magjike në vepër. Në gjuhën shqipe, urimet të cilat bëhen në situata të caktuara janë shumë të zakonta për ligjërimin bisedor. Kaq të zakonshme janë këto urime edhe për romanin *Rrathë*: *Ligështia më ndjek të tanë ditën. Tha dhe uroi si lypës: - Gjithmonë të dhafshin!*<sup>32</sup>

Formula magjike në vepër na del më shumë si formë besimi që ka personazhi i Dranashit apo Fetarit se përmes recitimit të këtyre vargjeve do të kishte fat, ashtu sikur e parashihte magjistarja e vjetër:

*Mullizezat hanë thoj,  
sorrat-dhambë,  
korbat-kufoma e ti dhe,  
përpije këtë dhimbë.*<sup>33</sup>

## PËRFUNDIM

---

<sup>32</sup> Po aty, fq. 82.

<sup>33</sup> Po aty, fq. 83.

Kanë kaluar më shumë se njëzet e shtatë vite që autori i romanit *Rrathë*, Martin Camaj ka kaluar në amshim, ndërsa rrugëtimi i studimit të kësaj vepre sapo ka hyrë në fazën e thellësisë dhe të përgatitjeve të mëdha për t'u shqyrtuar dhe studiuar gjithanshmërisht. Themi kështu sepse përmes veprës letrare *Rrathë*, ai hodhi shtegun e ri në letërsinë shqipe, sidomos me narracionin psikologjik të personazheve, duke krijuar një diskurs të ndërlikuar letrar.

Me zgjedhjen e simbolikës së shumëfishtë, personazheve interesante dhe një gjuhë shumë të pasur artistike, Camaj tregon dilemat e njeriut modern, të cilit i ka humbur beteja heroike legjendare dhe mitologjike e i ka mbetur vetëm një sistem i ri i cili ngulfat lirinë e tij në të gjitha format. Në krye të këtij sistemi, Camaj vë personazhin fatkeq të Bardhit, i cili ashtu sikur vjen në krye të pozitës ashtu edhe shkon, pa zhurmë. Paralel me të, Camaj ndërton edhe figurën e Agonit i cili mishëron më së miri fatin e shkrimtarit mbi censurë të kohës.

Martin Camaj me romanin *Rrathë*, ka dëshmuar se stili i tij i shkrimit është një gërshetim i përkryer i traditës etnofolklorike dhe mitologjike shqiptare. Këtë traditë e shpërfaq përmes personazheve të Folkloristit, Rapsodit dhe Soses. Përmes elementeve etno-folklorike si: këngë të vjetra të shoqëruara me lahutë, gojëdhënave të vjetra, dokeve, zakoneve, Camaj sjellë një botë unike para lexuesit. Ajo çka i kushtëzoi edhe lidhjen e fortë me mitologjinë në këtë vepër letrare është prania e figurës komplekse të Soses dhe raportit të saj me botën përreth. Sosja bëhet shkak i konfliktit mes gjeneratash, i cili na del një konflikt i hapur i mendësisë së të dy palëve.

Gjuha një element shumë i rëndësishëm për identifikimin e karakteristikave të personazheve është shprehur nëpërmjet diskurseve dhe fushës leksikore të saj. Përmes njësisive frazeologjike, si një formë që reflekton modelet kryesore të mendimit njerëzor, Camaj shpreh identitetin e personazheve të tij, duke pasqyruar më së miri lidhjen e tij me gegërishten dhe rëndësinë që ka për të ky dialekt letrar.

## Literatura

1. BERISHA, Anton, N. *Vepra letrare e Martin Camajt*, Princi, Tiranë, 2010.
2. CAMAJ, Martin. *Rrathë*, Camaj-Pipa, Shkodër, 2001.
3. ÇIRAKU, Ymer. *Bota poetike e Martin Camajt*, Albas, Tiranë, 2003.
4. KURTI, Ledri. *Drama apo tekste të dramatizuara: Loja e mbasdrekës dhe Kandili Argjandit në Martin Camaj për kulturën shqiptare; shkrimtari dhe albanologu*, Shkodër, 2011.
5. SINANI, Shaban. *Camaj i paskajuar, Rreth tipologjisë së llojeve në veprën e Martin Camajt*, studim monografik, QSA, Tiranë, 2011.
6. THOMAI, Jani. *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Shtëpia botuese e librit universitar, Tiranë, 2002.
7. ZISI, Roland. *Letërsi bashkëkohore shqipe-Poezia*, Naimi, Tiranë, 2015.